



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI

Nr. 3244/1 Prot.

Vlorë më, 15.12.2025

VENDIM

Nr. 123, datë 15.12.2025

PËR

PROPOZIMIN NË BORDIN E ADMINISTRIMIT TË UV-SË, NJË NDRYSHIM NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE, NUMERIKE DHE ORGANIGRAMËN E UNIVERSITETIT 'ISMAIL QEMALI' VLORE MIRATUAR ME VENDIM TË SENATIT AKADEMIK NR. 14, DATË 24.02.2025

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja ç, të Ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, gërma ç, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; nenit 13 të Rregullores së Brendshme të UV-së; Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr. 27, datë 29.12.2027, "*Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë*", si dhe referuar shkresës së Sektorit të Kërkimit Shkencorë dhe Projekteve me nr.3231 prot, datë, 12.12.2025, dhe shkresës së Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Arkivë-Protokollit, me nr. 3232 Prot., datë 12.12.2025, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 15.12.2025,

VENDOSI:

1. T'i propozojë Bordit të Administrimit të UV-së ndryshim të strukturës organizative, numerike dhe organigramën e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë si më poshtë:
 - 1 (një) personel i kategorisë Laborant, nga Qendra e Kërkimeve Shkencore pranë Fakultetit të Ekonomisë, të rialokohet pranë Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Projekteve duke u shtuar një pozicion si Specialist Projektsh pranë këtij Sektori.
Ky propozim nuk ka efekt financiar.
 - Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit, të shtohet me 1 (një) personel "Specialist Protokollit".
Ky propozim ka efekt financiar dhe numri i përgjithshëm i personelit ndihmës-akademik dhe administrativ ndryshon në 124 (njëqind e njëzetë e katër).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI

2. Ky Vendim propozohet për miratim përfundimtar në Bordin e Administrimit.
3. Bashkëlidhur këtij Vendimi, Struktura organizative dhe numerike e UV-së me ndryshimet e propozuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

PROF. DR. AURELA SALIAJ

A. Saliaj